DEKRET
Nr.7365, datë 24.3.1990

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR MBROJTJEN E DETIT MESDHE NGA NDOTJA DHE NË PROTOKOLLET E SAJ

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në aktet e mëposhtme:

1. Konventa për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja, nënshkruar në Barcelonë, në 16 shkurt 1976.

2. Protokolli për parandalimin e ndotjes së Detit Mesdhe nga hedhurinat e anijeve e të avionëve, nënshkruar në Barcelonë, në 16 shkurt 1976.

3. Protokolli për bashkëpunimin në luftën kundër ndotjes së Detit Mesdhe nga hidrokarburet dhe lëndë të tjera të dëmshme në raste të jashtëzakonshme, nënshkruar në Barcelonë, më 16 shkurt 1976.

4. Protokolli për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja prej burimeve tokësore, nënshkruar në Athinë, në 17 maj 1980.

5. Protokolli për zonat veçanërisht të mbrojtura të Mesdheut, nënshkruar në Gjenevë, më 3 prill 1982.

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia